



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.46/2018

Prishtinë, më 4 mars 2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla dhe Teuta Haxhiu,

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Mirjeta Kalludra, Saranda Bogujevci, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSBE, Drita Vitia-Radio Kosova, Agnesa Haxhiu-KDI, Mirsa Avdimetaj-Arbresh Info, Mirjeta Duraku-KosovaPress, Arbresha Shpati-Klan Kosova, Vatra Qehaja-LVV, Shahadije Dragaçina-KTV dhe Kenan Gashi-Avonet.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi i Peticioneve;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kryetarja konstatoi se anëtarët e Komisionit miratuan pa asnjë vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 28 janar 2019 dhe më 4 dhe 11 shkurt 2019.

2. Shqyrtimi i Peticioneve

Kryetarja, tha se në këtë mbledhje nuk kemi në procedurë shqyrtimin e Peticionit të Komunës së Mitrovicës sepse në Komision nuk është një peticion i tillë. Jemi në dijeni se lidhur me këtë Kryesia e Kuvendit ka kërkuar mendimin e Qeverisë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se si grup punues për shqyrtimin e Peticioneve, kanë trajtuar dy kërkesa për të cilat kemi vendosur dhe për këtë do ta njoftojmë komisionin, ndërsa sa i përket peticionit të Mitrovicës nuk jemi autorizuar për ta shqyrtuar.

Teuta Haxhiu, theksoi se kemi kërkuar por asnjëherë nuk ka pasur një shkresë që i është drejtuar Komisionit tonë një peticion të tillë. I kemi disa peticione tjera të cilat i kemi trajtuar veç e veç. Pra, e përmendëm rastin e znj. Drita Hajdari. Ka kohë që ne jemi marrë me këtë peticion e kemi shqyrtuar me seriozitet shumë të madh disa herë radhazi dhe asnjëherë të vetme nuk e kemi neglizhuar asnjë rast të vetëm, e aq më pakë të grupeve dhe 16 mijë qytetarëve, në peticionin në fjalë, t'i kemi të gjithë aktorët e pranishëm dhe të vendosim edhe për rastet individuale.

Duda Balje, kryetare, tha se ne si Kosovë nuk kemi ligj për peticion. Ne brenda Kuvendit kemi një rregullore, vetëm një nen dhe mendoj që ne si komision jemi të vetmit të cilët merremi me peticionet. Është e çuditshme pse nuk ka ardhur këtu ky peticion, por ne do të presim prej Qeverisë.

Shemsi Sylja: Kërkojmë të vijë sa më shpejtë nga Qeveria por edhe në Kuvend që ta kemi parasysh. Neve na ka ardhur një kopje nga Agim Bahtiri, kryetari i Komunës së Mitrovicës, ku i është drejtuar grupit parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

Kryetarja, tha se sa kam informata, te ne nuk ka ardhur asnjë peticion. Si grup parlamentar mund të kenë mendim, por ne jemi komisioni dhe shpresoj që prej Qeverisë do të vijë te ne në komision.

Luljeta Veselaj-Gutaj: Grupi punues për peticione deri më tani ka punuar me shumë korrektësi dhe ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe peticionet që kanë ardhur në Komision, pastaj ne si Komision kemi marrë vendime. Për rastin në fjalë, peticioni për qytetarët e Komunës së Mitrovicës, ne e kemi parë në media dhe kemi dëgjuar që peticioni dhe kërkesa i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe kjo qëndron në domenin e Kryesisë së Kuvendit se si ta procedojë tutje, në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sa i përket grupeve parlamentare, mendoj që nëse një grupi i është dërguar një peticion zyrtarisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës, atëherë është dashtë që t'ju dërgohet të gjitha grupeve parlamentare. Ne jemi disa përfaqësues të disa grupeve parlamentare dhe nuk e kemi në grupet tona parlamentare këtë peticion që qëndron brenda grupeve për shqyrtim.

Mexhide Mjaku-Topalli: Në grupin punues e kemi shqyrtuar se kënd duhet ta ftojme që të shqyrtohet kërkesa për ankesën për vendin e punës. Mendoj se duhet të ftohet përfaqësuesi nga Inspektorati i Punës në nivel vendi, përfaqësues nga Inspektorati i Arsimit në regjionin e

Ferizajt, përfaqësues nga Inspektorati i Punës në Lipjan dhe Drejtoria e Arsimit e Lipjanit dhe parashtruesja e kërkesës.

Ndërsa sa i përket Drita Hajdarit, kemi pranuar përgjigjeje nga IAP-i, dhe me atë përgjigje duhet të njoftohet pala.

3. Të ndryshme

Duda Balje, kryetare tha se kemi marrë përgjigje nga Ministria Kulturës Rinisë dhe Sportit për çështjen e burgut të Prishtinës, që të shndërrohet në muze. Është një çështje pozitive dhe jemi duke pritur edhe përgjigje nga disa ministri të tjera dhe mund të caktohet një takim me secilën ministri dhe të bëhet një plan se si të vazhdohet më tutje.

Mexhide Mjaku-Topalli, diskutoi lidhur me përgjigjen e pranuar nga ana e Ministrisë së Kulturës për çështjen e shndërrimit të burgut të Prishtinës në burg muze.

Nga shkresa që kemi marrë nga Ministria e Kulturës, kemi parë që është shqyrtuar çështja kur bëhet fjalë për kompleksitetin e ndërtesës. Ministria e Kulturës ka emëruar një grup ndërministror, i cili do të kryesohet nga Ministria e Kulturës, e ku në përbërje do të jenë edhe këto institucione të tjera relevante.

Kërkojmë të marrim përgjigjeje sa më shpejt nga këto institucione ose ta caktojmë një takim dhe të marrim përgjigje drejtpërdrejt edhe pse duhet me shkrim ta kemi një përgjigje.

Duda Balje: Nëse jeni edhe ju të pajtimit të caktohet një takim për javën e ardhshme me të gjitha këto institucione, shpresoj që nuk kemi asnjë institucion kundër shndërrimit të burgut të Prishtinës në muze.

Teuta Haxhiu: Është me interes që ky objekt të mos tjetërsohet, mos të humbin gjurmët që janë gjurmë të dhimbjes. E vlerësoj edhe këtë hap që ka bërë Ministria e Kulturës, por paraprakisht të gjitha këto institucione të na sjellin një dokument me shkrim, të diskutojmë dhe të veprojmë sa më parë.

Luljeta Veselaj-Gutaj, ngriti çështjen që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Ne jemi dëshmitarë të shumë rasteve të njerëzve që kanë humbur jetën në vendin e punës, ku shumë prej tyre kanë qenë të ri dhe njerëz me diploma, por kanë punuar punë të ndryshme. Mendoj që siguria dhe mbrojtja në vendin e punës nuk është vetëm obligim ligjor, por kjo është edhe nevojë thelbësore për përmirësim dhe progresin ekonomik të vendit.

Veselaj-Gutaj, propozoi që të ftohet në Komision ministri Skender Reqica, bashkë me përfaqësuesit e inspektoratit dhe të shohim se cilat masa janë duke i marrë konkretisht në raport me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Vetëm në muajin janar dhe shkurt i kemi dy raste që kanë përfunduar me vdekje tragjike në vendin e punës në sektorin privat.

Kryetarja, konstatoi që të ftohet në Komision ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Inspektorati i Punës në nivel qendror. Ajo njoftoi se ka pasur një takim me z. Halil Kurmehaj nga Iniciativa e të Verbërve dhe ata kanë kërkuar një takim me ministrin. Janë të kënaqur që ju kemi ndihmuar për të gjetur zgjidhje në disa probleme dhe kemi qenë shumë më efikas. Kanë gjetur zgjidhje edhe për transportin, për librezat e anëtarësisë, por prapë ata kanë pasur kërkesa konkrete. E kemi ftuar ministrin zotëri Reqica më 11 mars 2019, me temën e veçantë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se nëse kthehemi mbrapa në hartimin e planit të punës, propozimi im ka qenë që të thirret një tryezë dhe të ftohen të gjithë aktorët, ku do të diskutojmë për zbatimin e strategjisë dhe në fund të dalim me një rekomandim që të kërkojmë nga Qeveria, ta

përsheptomë procedurën dhe ta sjellim në Kuvend ligjin për gjithëpërfshirje për personat me aftësi të kufizuar,

Ajo njoftoi komisionin se më 4 shkurt 2019, kemi bërë kërkesë me shkrim nga Komisioni Funkcional, drejtuar Komisionit qeveritar për njohjen e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës për t'na sjellë një raport me shkrim për problemet apo mungesën e kushteve të punës, por nuk kemi marrë përgjigje.

Më tej, ajo njoftoi edhe lidhur me takimin e dytë të radhës të grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin Ligjit nga dhuna në familje. Kemi caktuar hapat konkret për të vazhduar tutje duke ditur që rregullorja e Kuvendit na lejon që të caktojmë një ekspert jashtë Kuvendit.

Lirije Kajtazi, tha se ajo personalisht ka pasur një kërkesë të personave të cilët e kanë pësuar nga regjimi i mëhershëm të cilët nuk janë përfshirë në ligj ose janë të plagosur ose janë torturuar në forma të ndryshme.

Më tej, ajo konstatoi se dëgjimi publik për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore të mbahet me 13 mars 2019.

Teuta Haxhiu: Shqetësimin që kemi për Komisionin qeveritar për rastet e dhunuara gjatë luftës edhe pse kemi pasur takime, por nuk janë serioze trajtimet e rasteve që i kemi, nuk i trajtojnë. Në rastin e fundit u ankuan për kushtet dhe ende nuk kanë kthyer përgjigje me shkrim, duhet të jenë shumë të përgjegjshëm për detyrat që i kanë marrë ose të deklarohen që nuk janë për ato detyra. Ta ngrisim shqetësimin tek ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, një shkresë drejtuar prej komisionit për rastet e tilla që po deri në 9 muaj. Nëse ka mungesë të kapaciteteve, le të na drejtohen neve si komision atëherë ne do ta mbështesim kërkesën për rritjen e kapaciteteve njerëzore, nëse është nevoja.

Mexhide Mjaku-Topalli: Unë kërkoj që ministri Reqica të vijë në raportim, jo vetëm për një çështje, sa janë afër hartimi i draft konceptit, kur është fjala për skemat pensionale, kur është çështja tek familjet e dëshmorëve, të cilëve padrejtësisht u ndalohe pensioni sepse skema pensionale e ndalon që të merren dy pensione në të njëjtën kohë. Të diskutohet edhe çështja sa ka mundësi të lëvizet nga ky ligj, sidomos me çështjen e financimit të familjeve të të zhdukurve.

Luljeta Veselaj-Gutaj: Është shqetësues edhe Ligji për personat e pagjetur. Tash sa kohë kemi premtime se Komisioni Qeveritar është duke punuar. Duhet ta kemi një shkresë, të dihet se a janë afër apo nuk janë dhe a kanë bërë diçka, nëse jo, atëherë mendoj që ne si komision e kemi përgjegjësinë për një nismë ligjore që të bëhet një ligj për personat e pagjetur.

Ju është bërë e padrejtë familjarëve të dëshmorëve me ndaljen e kontributeve të tyre, po ashtu, edhe për personat e pagjetur.

Duda Balje, kryetare, tha se organizata joqeveritare “Avonet” kanë bërë një deklaratë për media si dhe një kërkesë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që rasti i vajzës 16 vjeçare nga Drenasi të

kalojë për shqyrtim gjyqësor në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Një kërkesë të tillë kjo OJQ e ka bërë edhe te Komisioni për të Drejtat e Njeriut.

Lidhur me këtë çështje, ajo ia dha fjalën përfaqësuesit të kësaj organizate joqeveritare Kenan Gashi.

Luljeta Veselaj-Gutaj: Ne si komision e mbështesim çdo vendim që mund të jetë më i shpejtë, por si deputetë dhe si pushtet gjyqësor, janë dy pushtete me funksione të ndryshme dhe ne si Kuvend nuk kemi të drejtë të interferojmë në organet e drejtësisë. Janë organet kompetente, është Këshilli Gjyqësor, ai që vendosë se a do të shqyrtohet lënda në Drenas apo do të kalojë lënda në Ferizaj.

Lirije Kajtazi: Për shkak të komplikimit të situatës, mendoj që mund të kërkojmë nga Agjencia për Ndihmë Juridike të sigurojë një avokat falas, por në monitorim të rreptë të Avokatit të Popullit.

Kryetarja, në vazhdim theksoi se sot duhet ta hedhim në votim Propozim-Vendimin për angazhimin e z. Flamur Hyseni, në cilësinë e ekspertit për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi njëzëri Vendimin për angazhimin e z. Flamur Hyseni, në cilësinë e ekspertit për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Kryetarja, po ashtu, njoftoi se Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka kërkuar që të prezantojë një raport në Komision Funkcional.

Më tutje, ajo njoftoi anëtarët e Komisionit se Komiteti i grave të verbra të Kosovës, kërkon takim me Komisionin dhe më pas konstatoi se ata do të ftohen kur të mbahet tryeza për zbatimin e strategjisë për personat me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, komisioni vendosi që të behet një punëtori njëditor në Prevallë dhe të përfundohet me shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje